



South East Europe
Sustainable Energy
Policy



FITUESIT DHE HUMBËSIT

Kush përfiton nga korrupsioni i nivelit të lartë në
sektorin e energjisë në Evropën Juglindore?



Qershor 2014

Autori kryesor

Marko Prelec, Grupi Hulumtues për Politika të Ballkanit

Editor i rastit studimor

Pippa Gallop, CEE Bankwatch Network

Editor për SEE Change Net

Garret Tankosić-Kelly, SEE Change Net

I falënderojmë organizatat partnere të partneritetit SEE SEP (Programi i Politikave për Energjinë e Qëndrueshme në Evropën Jug-Lindore) - të listuara në faqen në vijim - për mbështetjen e tyre në përgatitjen e këtij raporti, si dhe gazetarët, avokatët, prokurorët dhe të gjithë të tjerët të cilët ndihmuan gjatë përpilimit.

Kopertina

Ana Lukenda

Radhitja dhe dizajni

Ivan Hrašovec



Ky publikim u mundësua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e SEE Change Net në emër të partnerëve zbatues të SEE SEP dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

- 3 Programi i Politikave për Energjinë e Qëndrueshme në Evropën Jug-Lindore
- 4 Parathënie - Rruga drejt Evropës
- 6 Përmbledhje
- 9 Rekomandime
- 11 Hyrje
- 19 Shqipëri: hetimi për pastrimin e parave
- 22 Shqipëri: rasti i hidrocentraleve me koncesion
- 24 Bosnje: rasti i tregtimit të energjisë EPBiH dhe EPHZHB
- 26 Kroaci: rasti i HEP-së për tregtimin e energjisë
- 28 Kroaci: the INA – Afera INA - MOL
- 30 Kosovë: rasti i shpifjeve për kontratën e KEK-ut
- 31 Kosovë: Afera UNMIK/KEK
- 32 Maqedoni: karteli i tregtimit të energjisë elektrike dhe rastet e evazionit tatimor
- 34 Mali i Zi: afera e vjedhjes së energjisë elektrike në KAP
- 36 Bosnje dhe Hercegovinë/Mali i Zi: Tregtimi i energjisë elektrike
- 38 Serbi: Skandali në minierën e Kolubarës

* Sipas OKB-së, Kosova është "nën Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), themeluar në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit." Në këtë studim, është referuar si "Kosova".

** Sipas OKB-së, emri zyrtar për Maqedoninë është "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë". Në këtë studim, është referuar si "Maqedonia".

Programi i Politikave për Energjinë e Qëndrueshme të Evropës Jug-Lindore

Me rreth 25 milionë qytetarë potencial të ri të BE-së në Evropën Juglindore, të cilët janë konsumatorë të energjisë, energjia është ndoshta një nga çështjet më komplekse me të cilën po përballet rajoni. Ajo ka ndikime të ndër-lidhura dhe të thella në shumë fusha, duke përfshirë shoqërinë, ekonominë dhe mjedisin, veçanërisht pasi Evropa Juglindore përballet me liberalizimin e shpejtë të tregut në vitin 2015 në një mjedis më pak se ideal të qeverisjes.

Programi i Politikave për Energjinë e Qëndrueshme në Evropën Jug-Lindore (SEE SEP) është projektuar që të trajtojë këto sfida. Ky është një program shumë-vjeçar dhe

shumë-vendesh i cili ka 17 OSHC partnere nga i gjithë rajoni (Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia) dhe BE-ja. Financiarisht mbështetet nga Komisioni Evropian, Trusti Ballkanik për Demokraci dhe UNDP.

Kontributi i projektit SEE SEP do të jetë në fuqizimin e OSHC-ve dhe qytetarëve që të ndikojnë më mirë në politika dhe praktika drejt një të ardhme energjetike më të pastër, më të drejtë dhe më të sigurt në Evropën Juglindore.



Supported by:

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND





PARATHENIE NGA DEPUTETJA ULRIKE LUNACEK
ZËVENDËS - KRYETARI I PARLAMENTIT EVROPIAN

RRUGA PËR NË EVROPË

Vitin e kaluar, më 1 korrik, Bashkimi Evropian e mirëpriti Kroacinë si shteti i 28-të anëtar dhe vendi i parë që përfundoi procesin e Stabilizim-Asociimit.

Të ballafaquar me atë që u konsiderua si një “mësim i mësuar” me pranimin e Bullgarisë dhe Rumanisë si anëtare të plota të BE-së, para se ato të dëshmonin veten e tyre si të afta që të luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar në të gjitha nivelet, BE priti që Kroacia të ofroj dëshmi të përshtatshmërisë së saj para se të përfundonin bisedimet për pranim. Bashkimi Evropian kërkonte që Kroacia të krijoj një “regjistër bindës të dënimeve” në rastet korrupsionit të nivelit të lartë.

Kroacia e bëri një gjë të tillë, duke hetuar, gjykuar dhe dënuar ish Kryeministrin Ivo Sanader për pranimin e më shumë se 10 milion Eurove si ryshfet nga firmat në Hungari dhe Austri, në fushën e energjisë. Rasti tregon se korrupsioni i nivelit të lartë nuk njihet kufij dhe duhet të luftohet seriozisht nga vendet anëtare të BE-së dhe po ashtu nga vendet kandidate.

Sot procesi i pranimit ngritet në kushtëzime strikte por të drejta dhe mësim të mësuara nga zgjerimet e mëherëshme. Një nga mësimet kyçe ka qenë rëndësia e adresimit të “çështjeve themelore”. Duke kujtuar parimet e kriterëve të Kopenhagës ne kemi theksuar disa çështje themelore:

Fillimisht, sundimi i ligjit mbetet në zemër të procesit të pranimit. Qasja e re për sundimin e ligjit të cilën e kemi lansuar

në vitin 2011 ka nevojë edhe për ndryshime kulturore. Kjo kërkon që në fillim të procesit vendet të sigurojnë që kanë kapacitete administrative dhe kjo duhet të mbështetet me vullnet politik. Kjo u jep vendeve kohë maksimale që të zhvillojnë një regjistër të qëndrueshëm të zbatimit, kryerjen e reformave të thella dhe të pakthyeshme dhe siguron që qytetarët do të ndiejnë të mirat gjatë procesit dhe jo vetëm në fund të tij.

Sundimi i ligjit është gjithashtu shumë i rëndësishëm ekonomikisht sa i përket sigurisë ligjore dhe besimit të investitorëve sidomos në sektorin e energjisë dhe për këtë është kyç për reformën ekonomike. Qytetarët duan dhe kanë nevojë për një sistem ligjor dhe rregullator transparent, efektiv dhe të paanshëm. Së dyti, vendosim propozime konkrete që do të ndihmojnë vendet e Ballkanit Perëndimor që të fuqizojnë qeverisjen e tyre ekonomike. Të gjithë janë të prekur nga papunësia. Të rinjtë e papunë kanë nevojë për veprime, vendime, dhe punë, kështu që është jetike që këto vende të mbështesin përpjekjet reformuese për të nxitur rritjen.

Shtetet e ardhshme anëtare përballen me një sfidë të rëndësishme në fushën e efijencës së energjisë për shkak të nivelit të ulët të prodhimit të energjisë dhe nivele të larta të konsumit të energjisë. Investimet e financuara nga BE-ja në masat për kursimin e energjisë në ndërtesat publike kanë sjellur një fitore të trefishtë për mjedisin, ekonominë dhe punësimin. Megjithatë, ende ka shumë punë për t'u



bërë, përfshirë këtu përmirësimet në efikasitetin e transmetimit dhe nxitjen e një kulture të kursimit të energjisë.

Së treti, theksojmë rendësinë e funksionimit të institucioneve që garantojnë demokracinë dhe që sigurojnë se proceset demokratike janë më gjithëpërfshirëse. Legjislaturat kombëtare kanë një rol jetik në sigurimin e zbatimit transparent dhe demokratik të të gjitha politikave, përfshirë këtu edhe energjinë.

Së katërti, dokumenti ynë strategjik fokusohet në respektimin e të drejtave themelore. BE-ja promovon lirinë e shprehjes në dialogun e saj me vendet aspiruese dhe mbështet përsosmërinë në gazetarinë hulumtuese, disa prej të cilave janë të përfshira në këtë raport. Shtetet kandidatë dhe kandidatët e ardhshëm për anëtarësim në BE duhet të sigurohen se gazetarët mund të bëjnë punën e tyre pa frikë nga dhuna dhe kërcënimet.

Këto elemente përbëjnë një proces të fortë dhe të hapur të anëtarësimit në BE i cili adreson të drejtat themelore, një proces në të cilin kandidatët dhe kandidatët potencial rrisin kredibilitetin e tyre përmes një regjistri të reformave dhe zbatimit. Angazhimi për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar edhe në nivelin më të lartë, për të ndërtuar institucione qeverisëse dhe transparente si dhe vullneti politik për të nxitur një shoqëri civile aktive, janë elemente kyçe të cilat janë të nevojshme për të arritur progres në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Kjo qëndron edhe për

sektorin e energjisë. Studimet e paraqitura në këtë raport tregojnë se frytet e investimit janë të mëdha, por i tillë është edhe tundimi. Komuniteti i energjisë ka zhvilluar një Strategji rajonale të energjisë në vitin 2012 e cila parasheh pothuajse 30 miliard Euro investime në Evropën Juglindore në dekadën e ardhshme. Kjo është një mundësi e mirë por edhe një test për vlerat themelore mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian: demokracia, sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave themelore. Këto investime mund të ofrojnë një nxitje transformuese për ekonominë e rajonit dhe të ndihmojnë kapacitetet e tyre që të jenë konkurruese me tregun Evropian. Ngjarjet e fundit në Ukrainë kanë theksuar rendësinë e sigurisë së energjisë në Evropë.

Reformat e nevojshme për anëtarësim në BE janë të ndërlydhura me zhvillimin e një strukture të sigurt dhe të qëndrueshme të energjisë në shtetet e Evropës Juglindore. I mbetet udhëheqësve dhe shoqërisë civile që të ndërtojnë një sektor të energjisë që nuk helmon mjedisin përmes ndotjes, apo qeverinë përmes korrupsionit.

Ulrike Lunacek,

Anëtare e Parlamentit Evropian (Gjelbërve / EFA Austria)
dhe nënkryetare e Parlamentit Evropian



Përmbledhje Ekzekutive

Energjia është tashmë një nga segmentet më të mëdha në ekonominë e Evropës Juglindore (EJL) dhe është e përcaktuar që të rritet edhe më shumë, nëse do të realizohen planet ambicioze të qeverive të rajonit. Shtetet palë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë planifikojnë rreth 28.8 miliard euro investime në energji nga vitit 2012 deri në vitin 2020 në Ballkanin Perëndimor.¹ Menaxhimi i këtyre investimeve do të jetë një sfidë ekzistenciale për shtetet e EJL-së. Ekonominë e tyre kanë nevojë për burime të sigurta të energjisë, dhe popullata e këtyre vendeve ka nevojë që energjia të jetë e pastër.

Historikisht, projektet e kësaj shkalle shpesh janë shënuar nga korrupsioni, i cili i ka larguar investitorët e njohur dhe ka ngritur shpenzimet. Gjithashtu, ka nënkuptuar mundësi të zvogëluara për zhvillim të qëndrueshëm të energjisë, duke humbur burimet, duke ndikuar në tregje, duke e devijuar interesin publik drejt interesave private, duke e bazuar vendimmarrjen kundër kriterëve racionalë të qëndrueshmërisë dhe në favor të interesave personale.

Ndërtimi i një infrastrukture moderne të energjisë duhet të shkojë paralelisht me forcimin e sundimit të ligjit. Problemi është kompleks dhe ryshfeti i thjeshtë është vetëm një pjesë e vogël. Disa forma të korrupsionit është shumë vështirë ose e pamundur që të ndiqen penalisht ose nuk e

shkelin asnjë ligj. Detyra nuk ka të bëjë aq shumë me zhdukjen e abuzimeve të herëpashershme të pushtetit publik për përfitime personale, por ka të bëjë me ndërtimin e institucioneve qeverisëse mirë të rregulluara, të besueshme dhe transparente që janë të lidhura me sundimin e ligjit.

Shumë nga ajo që është e njohur në lidhje me korrupsionin në sektorin e energjisë vjen nga dy burimet komplementare. Organet ndërqeveritare të tilla si Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe Komisionit Evropian (KE) raportojnë mbi vendosjen e standardeve, ndërsa raportuesit dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) hetojnë patronazhin dhe korrupsionin. Disa prej rasteve të cilat ata i kanë publikuar kanë përfunduar në gjykatë. Për të gjithë ata të përfshirë, duke përfshirë këtu edhe prokurorët dhe gjykatësit, paanshmëria dhe pavarësia kanë qenë dy cilësi të fituara me mund.

Në luftën kundër korrupsionit në sektorin e energjisë shumë shpesh individët, qofshin ata gazetar, aktivist të OJQ-ve, prokurorë të shtetit apo informator nga brenda sistemit, marrim përsipër detyrën e vetme, atë të kërkimit të drejtësisë. Ata punojnë në një mjedis sfidues, e shumë shpesh armiqësor, të rrezikuar nga presioni apo kërcënimet nga zyrtari si dhe nga keqpërdorimet e pushtetit për të heshtur zërat që nuk ju shkojnë atyre për shtati.

1 Kjo figure perfshine Moldova. Annex 19, p.12.



PËRMBLEDHJA E RASTEVE

Rastet studimore në këtë raport janë të marra nga materialet të bëra publike dhe janë hetuar apo kanë qenë pjesë e padive. Ato nuk përfaqësojnë shkallën e plotë apo fushë-ëveprimin e korrupsionit në sektorin e energjisë në secilin vend, pjesërisht për shkak të faktit se problemi fillon të bëhet i dukshëm vetëm atëherë kur shteti fillon të reformohet seriozisht.

Shqipëria 1: Hetimi për pastrimin e parave

Rasti i Argita Berishës ka të bëjë me blerjen e tokës në Shqipëri jo shumë kohë para se qeveria ta zgjedh atë si vendin e një projekti të energjisë, duke e rritur vlerën e saj. Avokati i blerësit ishte e bija e atëkohë kryeministrit Sali Berisha, ndërsa administratori i firmave vendore të blerësit ishte kunati i ish-Ministrit të Transportit, Lulzim Basha.

Shqipëria 2: Rasti i hidro-koncesionit

Shikuesit e televizionit shqiptar e panë një video-incizim të një kamere të fshehur e cila tregonte Ilir Metën, atëkohë zëvendës kryeministër, i cili mundahej që të korruptonte një koncesion të hidrocentraleve, duke nxitur një zemërim të gjerë. Ekspertët Amerikan dhe Britanik të forenzikës e konstatuan xhirimin si autentik, por gjykata e hodhi poshtë këtë për arsye procedurale dhe e caktoi ekspertin e vet lokal, i cili konstatoi se incizimi ishte përpunuar. Ilir Meta gjithashtu është akuzuar për marrjen e ryshfetit prej 1 milion Euro për favorizimin e një biznesi në tenderin e naftës së papërpunuar. Në janar të vitit 2012, Gjykata e Lartë në Tiranë e liroi Ilir Metën për mungesë të provave.

Bosnja dhe Hercegovina 1: Rasti i tregtimit të energjisë EPBiH dhe EPHZHB

EPBiH dhe EP HZHB janë dy kompanitë të energjisë elektrike në pronësi të shtetit në Federatën e Bosnjës dhe

Hercegovinës, një prej entiteteve politike që e përbën shtetin sovran të Bosnjës dhe Hercegovinës. Autoritetet shtetërore në të dy rastet, me më shumë se dhjetë vjet distancë mes tyre, vendosën që të tregtojnë tepricën e energjisë së EP BiH përmes tregtarëve, e cila ishte e dëmshme për kompanitë shtetërore dhe pati një fitim të madh për kompanitë private të përfshira.

Kroacia 1: Rasti i tregtimit të energjisë së HEP-së

Afera e HEP-TLM ka të bëjë me shitjen e energjisë nën normat e tregut nga ana e ofruesit Kroat HEP, për dy fabrika; TLM në Kroaci dhe Aluminji në Bosnje e Hercegovinë, të cilat i kushtuan HEP-it rreth 85 milion Euro. Prokurori shtetëror pretendoi se Ivo Sanader, në atëkohë Kryeministër, kishte pranuar më shumë se 1.5 milion Euro si ryshfet nga një ish-nëndegë e Daimler me lidhje në Aluminj, e cila i premtoi TLM-së një furnizim të favorshëm me alumin.

Kroacia 2: Afera INA – MOL

Një tjetër rast kroat është INA-MOL, në të cilën gjykata e dënoi atëkohë Kryeministrin Sanader për marrjen e 10 milion Euro ryshfet nga kompania Hungareze e naftës MOL, në mënyrë që t'i jap MOL-it një pozitë dominuese në kompaninë kroate të naftës INA. Prokurori i shtetit gjithashtu ka akuzuar kryetarin e grupit MOL Zsolt Hernádi, i cili i ka mohuar shkeljet; Hungaria refuzoi ekstradimin.

Kosova 1: Rasti i shpifjeve lidhur me kontratën e KEK-ut

Në prill të vitit 2012 Arbana Xharra nga gazeta e paravarur ditore Zëri shkroi një artikull duke komentuar se afaristi Bejtush Zhugolli dhe dy vëllezërit e tij, janë duke e mbështetur financiarisht fushatën zgjedhore të kryeministrit Thaçi dhe se në këmbim ata fituan kontrata të majme në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK). Menjëherë pas publikimit të artikullit, Bejtush Zhugolli padii Xharren dhe gazetën Zëri, megjithatë Xharra u shpall e



pafajshme. Kur Selvije Bajrami, një tjetër gazetare në Zëri, publikoi një raport për seancën e parë gjyqësore, Zhugolli e paditi edhe atë, por edhe ajo u shpall e pafajshme.

Kosova 2: Afera UNMIK/KEK

Një gjykatë gjermane dënoi Z. Jo Trutschler, menaxher i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) në emër të UNMIK-ut, për shkelje të besimit dhe keqpërdorim të titullit akademik dhe e dënoi me tri vjet burg. Nga vitit 2000-2002 u zbulua se ai kishte marrë rreth 4.3 milionë dollarë (atëherë rreth 3.7 milion euro) dhe e kishte transferuar këtë shumë tek kompanitë fiktive në Gjibraltar. Hetuesit e OKB-së zbuluan se përveç kësaj Trutschler kishte falsifikuar diplomën e tij dhe kishte deklaruar përvojë më të madhe në menaxhim se sa ai kishte në të vërtetë. Shumica e parave u rikthyen.

Maqedoni: Rasti i kartelit për tregtinë e energjisë elektrike

In 2012 the AntimNë vitin 2012 Komisioni anti-monopol i Maqedonisë ngriti padi për kundërvajtje kundër katër firmave për tregtimin e energjisë elektrike mbi dyshimin se kishin krijuar një kartelë, në mënyrë që të mund të diktojnë çmimin e importit të energjisë elektrike përmes ofertave të tyre në një tender të vitit 2012. Më vonë gjatë vitit, zyra e doganave gjithashtu paditi tre kompani të tregtimit të energjisë elektrike në lidhje me ngarkesat shtesë doganore, duke thënë se ato kishin përdorur metoda të ndryshme për t'ju shmangur pagimit të këtyre taksave.

Mali i Zi 1: Afera e vjedhjes së energjisë nga KAP

Në mes të muajit mars dhe maj të vitit 2013, Qeveria malazeze i kishte lejuar Fabrikës së Aluminit të Podgoricës (KAP) që të vjedh energjinë nga sistemi evropian i ndërlidhjes energjetike, pasi që kompania malazeze e energjisë i kishte

shkëputur ata për shkak të mos pagesës. Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike (ENTSO-E) urdhëroi Malin e Zi që të rikthej energjinë e vjedhur, përndryshe ata rrezikojnë që të përjashtohen nga rrjeti Evropian. Qeveria u pajtua që ta bëjë këtë, por shpenzimet po i ngarkohen tatimpaguesve përmes buxhetit shtetëror dhe konsumatorëve përmes faturave të fryra të energjisë elektrike.

Mali i Zi 2: Afera e USAID-it

Në vitin 1999 USAID-i i dha qeverisë malazeze një donacion prej 11.9 milionë dollarësh (atëherë ekuivalente me 13.4 milionë euro), pjesë e të cilit ishte që të mbulohen borxhet e importit të energjisë elektrike të EPCG-së nga Republika Srpska në Bosnje dhe Hercegovinë. Megjithatë, afaristi serb Vuk Hamović, atëbotë drejtor i GML-it më bazë në Londër, i bleu borxhet e EPCG-së pak para donacionit të USAID-it, duke ngritur dyshimet që paratë e USAID-it po devijoheshin me qëllim drejt GML-së. Hetimet nga Zyra e MB-së për mashtrime

të rënda, Prokurori i Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Inspektorit të Përgjithshëm të USAID-it përfunduan pa ndjekje penale.

Serbia: Skandali i minierës Kolubara

Në vitin 2011, Policia Serbe arrestoi ish-drejtorin e kompanisë minerare Kolubara dhe 16 të tjerë nën akuzën e dëmtimit të paligjshëm të kompanisë përmes marrjes së papërshtatshme të pajisjeve dhe falsifikim të orëve të operimit. Rasti ende nuk është përfunduar.

Rekomandime

Për të adresuar problemet e identifikuara në këtë raport, ne rekomandojmë:

- Donatorët duke përfshirë shtetet dhe Komisionin Evropian duhet kushtëzojnë ndihmën e ndërlidhur me energjinë me përputhjen progresive me kushtet e forcuar² të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.
- KE-ja duhet të monitoroj nga afër privatizimin e firmave të energjisë në pronësi shtetërore dhe tenderimin për projekte të reja.
- Ka rrugë të ndryshme për të reformuar firmat energjetike në pronësi shtetërore. Shtetet të cilat zgjedhin që të privatizojnë, duhet ta bëjnë privatizimin duke e punësuar një firmë ndërkombëtare me reputacion dhe përvojë që të merret me procesin dhe duhet të publikojnë të gjitha fazat e procesit, me kohë të mjaftueshme për komentim të publikut.
- Shtetet të cilat i mbajnë aksionet kontrolluese në firmat energjetike duhet të mbrohen nga korrupsioni i drejtorëve, për shembull duke i deleguar votat e tyre tek një agjenci e pavarur, apo duke përzgjedhur drejtorët në bashkëpunim me punonjësit.
- Operatorëve të firmave energjetike duhet t'ju kërkohej që të publikojnë të dhënat mbi gjenerimin, konsumimin, tregtimin dhe lëvizjen e çmimit në internet në kohë reale.
- Tregu i importit të energjisë elektrike mund të jetë një biznes shumë fitimprurës. Rregullat dhe rregulloret që trajtojnë këtë import duhet të fuqizohen, njësoj sikurse duhet të fuqizohet edhe mbikëqyrja e tregtarëve.
- Kapacitetet e institucioneve që merren me mbikëqyrjen e punës së tregtarëve të energjisë (zyrave të doganave, komisioneve anti-korrupsion dhe anti-monopol, etj) duhet të fuqizohen profesionalisht dhe financiarisht. Pavarësia e tyre duhet të garantohet. Kapacitetet e prokurorëve dhe gjykatave që merren me raste të tilla duhet të fuqizohen përmes trajnimeve shtesë.
- Për të luftuar korrupsionin në përgjithësi, BE-ja duhet të krijoj qendra të bankave jashtë vendit për të

shpalosur asetet tek autoritetet kundër-korrupsionit dhe publikut, veçanërisht ato të mbajtura nga zyrtarët publik të EJT-së, duke përfshirë ekzekutivin e kompanive në pronësi publike dhe familjet e tyre.

- Shtetet e EJT-së duhet t'i publikojnë në internet informatat financiare duke përfshirë deklarin e aseteve dhe kthimet tatimore të zyrtarëve publik dhe drejtuesve të kompanive në pronësi publike.
- Për të përparuar lirinë e fjalës, BE-ja dhe/apo OSBE-ja duhet të hapin linjat pa pagesë të deleguara për të pranuar ankesat për kërcënim, ndikim të padrejtë apo format e tjera të presionit kundër gazetarëve.

Për të edukuar publikun dhe për të mbrojtur mjedisin, vendet e EJT-së duhet të :

- Bëjnë përditësimin e shpeshtë të të dhënave për cilësinë e ajrit dhe ujit, të publikuara në internet dhe në mediat e shkruara dhe elektronike.
- Të inkurajojnë publikimin pro-aktiv të informatave mbi vendimmarrjen lidhur me energjinë, por gjithashtu të bëjë publike dokumentet mbi tregtinë e energjisë, projektet e reja, privatizimin, etj.
- Vendet e EJT-së duhet të bëjnë prioritet zhvillimin e shumëllojshëm për krijimin e qëndrueshëm të energjisë së ripërtërishme, përveç hidrocentraleve, duke vendosur synime ambicioze për energjinë nga era, diellore dhe nga biomasa për vitin 2030.

² Komuniteti i Energjisë duhet të miratojë legjislacionin e prokurimit publik dhe operacionalizoj dispozitat e saj të ndihmës shtetërore



Përveç këtyre rekomandimeve të përgjithshme, ne kërkojmë që:

- Shqipëria duhet të forcoj zyrën e prokurorit publik dhe urgjentisht të avancoj planet për të reformuar gjyqësorin e vet në bashkëpunim me BE-në;
- Bosnja dhe Hercegovina duhet të adresoj dobësitë e kompanisë shtetërore të transmisionit Elektro-prijenos (Transco); të harmonizoj legjislacionin për subjektet e energjisë, duke siguruar që ai përputhet me *acquis*; dhe të reformoj të tre prodhuesit dhe furnizuesit e energjisë elektrike në pronësi publike;
- Kosova duhet të vazhdoj urgjentisht dekomisionimin e centralit Kosova A dhe të zhvilloj një strategji të shumëllojshme të energjisë;
- Maqedonia duhet të miratoj dhe zbatoj ligje të rrepta që mbrojnë lirinë e fjalës dhe de-kriminalizojnë shpifjen; tregu për importin e energjisë elektrike është një biznes shumë-fitimprurës në Maqedoni, pasi që rreth 40% e të gjithë energjisë elektrike në vend importohet për shkak të mungesës së prodhimit vendor. Rregullat dhe rregulloret që merren me këto importe duhet të fuqizohen si dhe mbikqyrja e tregtarëve.
- Mali i zi duhet të përmirësoj qasjen në informacionin e ndërlidhur me kontraktimin publik në sektorin e energjisë, burimet e reja energjetike, privatizimin etj. Roli i policisë dhe prokurorisë duhet gjithashtu të fuqizohet dhe të jetë në përputhje me nevojën që të kemi shembuj pozitiv në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar në këta sektorë. Gjithashtu, duhet të bëhen përpjekje shtesë në individualizimin e përgjegjëseve për vendimmarrje në sektorin e energjisë.
- Serbia duhet të ndjek çështjen Kolubara sa më shpejt që të jetë e mundur, të heq mbështetjen shtetërore nga sektori i qymyrit dhe të punoj për të diversifikuar përzierjen e energjisë në drejtim të energjisë së ripërtërishme me rritje të efikasitetit të energjisë në mënyrë që të zvogëloj varësin nga pellgu Kolubara.

Hyrje

Energjia tashmë është njëra nga segmentet më të mëdha të ekonomive të shteteve të Evropës Juglindore (EJL) ³ dhe është vendosur të rritet edhe më shumë nëse realizohen planet ambicioze të qeverive të rajonit. Shtetet anëtare të Traktatit të Komunitetit të Energjisë planifikojnë të investojnë rreth 28.8 miliard euro në energji për periudhën 2012-2020 në Ballkanin Perëndimor⁴ ASikur vendet e tjera në tranzicion, amortizimi i infrastrukturës së gjenerimit të energjisë duhet të nxirret jashtë përdorimit brenda dekadës së ardhshme dhe sfidë mbetet se si do të zëvendësohen ato. Rajoni mbështetet kryesisht në dy burime të energjisë, atë të thëngjillit dhe ujit. Disa shtete, si Shqipëria, janë të mbi-varura nga energjia e ujore dhe rrezikohen nga reshjet e çrregullta dhe rënie të mundshme të reshjeve për shkak të ndryshimeve klimatike. Shtetet tjera si Kosova kanë bekimin e dyshimtë (ose mallkimin e burimeve) të energjisë me linjit e cila është jo efikase ⁵ dhe ndotëse, që mund të ketë efekte shkatërruese mbi cilësinë e ajrit dhe shëndetin.⁶

TKriza e Ukrainës ka theksuar varësinë e paqëndrueshme të Evropës ndaj importit të gazit rus. Disa shtete të EJL-së

llogarisin tek tubacioni i gazit Rus të Rrjedhës Jugore, por kundërshtimet e Komisionit Evropian (KE) mund të

shfuqizojnë projektin. ⁷ Dy tubacionet tjera, Jon Adriatik dhe Trans Adriatik, munden ose jo të jenë të realizueshme. Vetëm Kroacia ka energji të konsiderueshme bërthamore⁸ dhe të erës dhe asnjë shtet tjetër i EJL-së nuk ka instaluar burime diellore apo nga biomasa. Shumica e diskutimeve të investimeve në energji fokusohen në projekte të linjtit dhe burime të paqëndrueshme të hidroelektraneve të mëdha që mund të dëmtoj ekosistemet unike të ujërave të ëmbla dhe peizazhet. ⁹

Investimet në energji do të veprojnë në një kontekst të formësuar nga integrimi gradual i rajonit në Bashkimin Evropian. Rruga përpara është e qartë, por jo pa sfida: sipas KE-së, asnjë nga shtetet në Evropën Juglindore nuk ka një ekonomi funksionale të tregut ¹⁰ BE-ja e ka vendosur "sundimin e ligjit" në zemër të procesit të zgjerimit, duke vënë në dukje se ligjshmëria "mbështet mjedisin e biznesit, ofron siguri ligjore për operatorët ekonomik dhe krijon

3 Për qëllimet e këtij dokumenti, rajoni i Evropës Juglindore përfshin Shqipërinë, Bosnjë Hercegovinën, Kroacinë, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Sipas OKB-së, Kosova është "nën Misionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i themeluar në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit"; në këtë dokument është referuar si "Kosovë". Sipas OKB-së, emri zyrtar i Maqedonisë është "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë"; në këtë dokument është referuar si "Maqedonia". Bosnja dhe Hercegovina është referuar edhe si "Bosnja" ose "BiH".

4 Këto të dhëna përfshijnë Moldavinë. Shtojcë 19, fq.12.

5 Çuditërisht, ndoshta ekonomia e linjtit është duke u përqesuar edhe më keq (p.sh. Šoštanj 6 në Slloveni parashikohet të humbasë 50 milionë Euro në vit, kështu që edhe në anën e parave nuk është aq tërheqëse në qoftë se janë aplikuar standarde të larta.

6 Një studim nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka gjetur se "qiradhënia e burimeve natyrore zvogëlon shanset e një vendi që të bëhet më demokratik". Raporti i Tranzicionit 2013: Stuck in Transition? BERZH, f.28.

7 Lawrence Norman, "BE i ka thënë Bullgarisë që të ndërpres punën në projektin e Gazprom Rrjedha Jugore", Wall Street Journal, 3 qershor 2014".

8 Centrali Krško, në Slloveni, i planifikuar që të mbyllet në 2023, por për të cilin mund të kërkohej një vazhdim i përhershëm i kontestueshëm.

9 Më të drejtë, më të pastër, më të sigurt: Drejt një qasje më të qëndrueshme, e përqendruar në popullatë në zhvillimin e energjisë në Evropën Juglindore", Rijeti i EJL për Ndryshim, gusht 2011.

10 "Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2013-2014", Komisioni Evropian COM (2013) 700, 16 tetor 2013 fq.4. Si një anëtare e BE-së, Kroacia supozohet të ketë një ekonomi tregu funksionale, ashtu si edhe Islanda dhe Turqia mes vendeve kandidate.



nxitjen e investimeve, vendeve të punës dhe rritje.”¹¹ Pjesë e kësaj është lufta kundër korrupsionit të nivelit të lartë, një “shqetësim serioz në shumë vende të zgjerimit”.¹² ANJë pjesë tjetër është media e lirë dhe e pavarur e aftë t’i nuhas marrëveshjet e korruptuara që liderët kanë fshehur.

Shtetet e Evropës Juglindore kanë treguar shumë pak aftësi për të thithur investimet në këtë shkallë pa korrupsion dhe patronazh sistematik. Nuk ka asnjë arsye për të besuar se projektet e energjisë do ti procedojnë ndryshe ndërrimet e rëndësishme që mungojnë në politikën e skenave të brendshme dhe ndërkombëtare. Një vëzhgues sezonal e ka përshkruar sistemin e Ballkanit si “kontroll politik i burimeve të pasurisë ekonomike.”¹³ Secili nga hapat në një projekt të energjisë mund të përdoret për përfitime personale ose partiake. Tenderi mund të gjeneroj ryshfet; mund të angazhohen firma të ndërtimit të lidhura me udhëheqësit e partive dhe aleatëve të tyre; centrali elektrik krijon pozita drejtuese ku liderët e tepërt të partive mund të vendosen dhe krijohen vende të punës të nivelit më të ulët për mbështetësit; të ardhurat operative mbushin arkat e qeverisë; dhe më në fund energjia e gjeneruar mund të tregtohet më ultë se normat për të favorizuar shqetësimet tjera të rëndësishme politike. “Për një mori arsyes historike dhe aktuale,” një studiues i çështjes argumenton, “sundimi i ligjit dhe cilësia e administratës publike janë shumë të dobëta. Është vështirë të shihet se si acquis-i i energjisë mundet të përparojnë në një mjedis të tillë të brishtë”.¹⁴

KORRUPSIONI

Ekziston një perceptim i përhapur i korrupsionit masiv në Evropën Juglindore, e cila mbështetet nga gjetjet kërkimore nga një varg i burimeve, duke përfshirë Transparency International dhe Bankën Botërore. Barometri Global i Korrupsionit të Transparency International është i dobishëm në atë se ajo mat një gamë të gjerë të opinionit popullor

dhe përvojës.¹⁵ Vlerësimet e KE-së në raportet vjetore të progresit kryesisht përputhen me këto rezultate sasiore, por ato ndryshojnë në disa vende, të paktën në theks dhe zë. Ndoshta, për t’i shpërblyer vendet që kanë bërë një përpjekje nga një pikë më e ulët fillestare.

Në Shqipëri (para ndryshimeve të fundit në qeveri) një masë e habitshme prej 81 për qind e të anketuarve e vlerësonin gjyqësorin të “korruptuar ose jashtëzakonisht të korruptuar”.¹⁶ Mendimi i ekspertëve pajtohet, ku vendi radhitet në vendin 116 në botë.¹⁷ Sipas Bankës Botërore, Shqipëria shënoi rezultate shumë të ulëta në sundimin e ligjit (35 pikë përqindjeje; rezultate më të larta janë më të mira dhe më keq në korrupsion 27 përqindësh).

Bosnja dhe Hercegovina vuan nga një “kornizë e dobët ligjore” që është “e ndjeshme ndaj korrupsionit” dhe në gjykata të saj ka “shumë pak raste të korrupsionit që rezultojnë në dënime penale dhe edhe më pak raste arrijnë tek vendimet përfundimtare”.¹⁸ KE-ja pajtohet dhe shpreh pakënaqësi për “nivelin e lartë të korrupsionit [ndërsa] mungojnë masa efektive parandaluese kundër pastrimit të parave “dhe” ende ka mangësi serioze sa i përket pavarësisë, efektivitetit, llogaridhënies dhe paanshmërisë së gjyqësorit”.¹⁹ 65 përqind e të anketuarve e përshkruajnë gjyqësorin si të korruptuar, mirëpo zyrtarët publik dhe nëpunësit civil janë kuotuar edhe më lartë (67 përqind) dhe partitë politike (77 për qind). Ekspertët e radhitin në vendin e 72-të, ndërsa Banka Botërore e radhit dikur në mes të vendeve në botë me një përqindje prej 48 përqindësh tek sundimi i ligjit dhe 49 pikë përqindjeje për korrupsion.

11 “Strategjia e Zgjerimit,” fq.6.

12 “Strategjia e Zgjerimit,” fq.7.

13 Rafi Gregorian, fjalim në Circle 99, Sarajevë, 19 tetor 2008, në dispozicion në ohr.int. Gregorian argumentoi se “partitë politike krijojnë pasuri nga ekonomia përmes dy mënyrave kryesore ... duke i vendosur miqtë e tyre në krye të bordeve drejtuese dhe menaxhuese të kompanive publike [dhe] duke mbajtur kontrollin e tokës ndërtimore dhe tokës bujqësore.”

14 Alan Riley, “Zhvendosja e stimuljeve të energjisë: Përforsimi i integritetit të Evropës Juglindore në BE,” CEPS Policy Brief No. 296, 8 korrik 2013, fq.4.

15 Jesper Johnson dhe Deborah Hardoon, “Pse, kur dhe si të përdorin Barometrin Global të Korrupsionit, Chr. Instituti Michaelson përmbledhje e shkurtër U4, korrik 2012.

16 Transparency International, Barometri Global i Korrupsionit 2013. Të gjitha referencat e ardhshme i referohen “të anketuarit” janë në hulumtimet e kësaj kategorie, njëjtë edhe “të korruptuar ose jashtëzakonisht të korruptuar”.

17 Transparency International, Perceptimi i Indeksit të Korrupsionit 2013 Rangimi është bërë nga 177 vendet e anketuara, me 1 duke qenë pozita më e mirë; referencat e ardhshme për “ekspertë” janë në këtë renditje.

18 Transparency International, Përmbledhje.

19 “Strategjia e Zgjerimit,” fq.35-36.

Si anëtar i vetëm i BE-së në këtë grup, Kroacia nuk është më subjekt i asaj vëmendje që KE-ja i kushton të tjerëve. Në disa aspekte anëtar i ri i BE-së qëndron jashtë kësaj; Banka Botërore e ka vlerësuar me rezultatin më të mirë, lidhur me sundimin e ligjit, në këtë grup (60), dhe ka fituar vlerësimin më të lartë të ekspertëve për Transparencë (57). Megjithatë, në disa rangime tjera Kroacia radhitet mes shteteve tjera të EJT-së: një mase prej 71 për qind e të anketuarve tha se gjyqësori është i korruptuar.

Kosova ka një problem serioz me korrupsionin dhe sundimin e ligjit; 80 për qind e të intervistuarve thanë se gjyqësori është i korruptuar dhe ekspertët e vënë atë në vendin e 111 në botë. Rezultatet e Bankës Botërore janë të ngjashme (36 pikë përqindjeje në sundimin e ligjit, 30 për korrupsion). KE-ja është e shqetësuar se “Ndërhyrja politike në punën e gjyqësorit mbetet një shqetësim serioz.”²⁰

Maqedonia ofron një kontrast dramatik mes miratimit të shpejtë të ligjeve të modeluar mbi *acquis-in* e BE-së dhe rezultatet e saj të dobëta në arritshmërinë e këtyre ligjeve. KE-ja ka vlerësuar përpjekjet e Maqedonisë kundër korrupsionit, por identifikoi se “korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem serioz, duke treguar se zbatimi i legjislationit ekzistues ende nuk ka bërë ndikim konkret”. Ndërkohë, “shumë ndjekje dështojnë për të arritur në fazën e gjykimit dhe dënimit ose zgjasin shumë kohë për të bërë këtë për shkak të ri-gjyimeve të përsëritura.”²¹ Hulumtimet vërtetojnë se: 68 për qind e të anketuarve ende besojnë se gjyqësori është i korruptuar, ndërsa ekspertët e radhitin në vendin e 67-të.

Mali i Zi është në të njëjtën pozitë me Maqedoninë pra në vendin e 67 në botë mbi perceptimin e korrupsionit. Banka Botërore ka dhënë rezultate relativisht të larta (55) në sundimin e ligjit dhe korrupsion, edhe pse KE-ja paralajmëroi se “korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe mbetet një problem serioz.”²²

Serbia shënoi rezultatin më të keq për korrupsionin në mesin e popullit të saj, 82 për qind vlerësonin gjyqësorin të korruptuar, dhe pothuajse (78 përqind) kanë ndarë mendimin e njëjtë për zyrtarët publikë dhe nëpunësit civil. Ekspertët e kanë vlerësuar në pozitën 72-të dhe Banka Botërore e

vendos atë në 44 pikë përqindjeje në sundimin e ligjit dhe 48-të në korrupsion.

Diversiteti i përvojave në rajon është i jashtëzakonshëm dhe sugjeron disa modele. Shqipëria dhe Kosova kanë më së shumti punë për të luftuar korrupsionin, por renditen në mes sa i përket lirisë së shtypit dhe shoqërisë civile. Maqedonia dhe Mali i Zi janë duke përparuar me shpejtësi në masat anti-korrupsion të kërkuara nga BE-ja, por ende paraqesin një shkallë të shtypjes së medias jo të njohura për BE-në (shih më poshtë). Bosnja dhe Serbia performojnë në një nivel të ngjashëm, por kjo e fundit frustron KE-në me stagnimin e saj, ndërsa Serbia fiton pikë për ndërrime dramatike në politikë. Kroacia udhëheq këtë grup, edhe pse jo gati në distancë që pritej nga një shtet i ri anëtar i BE-së.

ENERGJIA

Të gjitha shtetet duhet të gjejnë dhe sigurojnë burime të pastra të energjisë gjatë dekadave të ardhshme, por secila ka grupin e veçantë të sfidave.

Shqipëria ka burime hidroenergjetike, por është e “mbi-varur nga hidroelektranat dhe është e ndjeshme ndaj kushteve hidrologjike”;²³ Ajo ka në plan të marrë pjesë në gazsjellësin Trans Adriatik (TAP), në qoftë se realizohet. Qeveria e re ka shpallur një ankand për gjetje të reja të naftës në vend se të negociacion koncesione.²⁴ Sfidë ka pasur me privatizimin e aseteve të saj të energjisë. Një përpjekje skandaloze për të shitur firmën shtetërore të naftës Albpetrol ka dështuar.²⁵ Shteti mori kontrollin e distributorit të privatizuar “CEZ Shpërndarje” nga pronarët e saj Çekë, të cilët kanë dërguar Shqipërinë në arbitrazh.²⁶ Komuniteti i Energjisë e ka gjykuar atë si “më së paku në përputhje” në Komunitet dhe të penguar nga një model tregu kufizues që “kurrë nuk do

20 KE, Kosovë * Raporti i Progresit 2013, fq.12.

21 KE, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raporti i Progresit 2013, fq.11.

22 KE, Mali i Zi, Raporti i Progresit 2013, fq.9.

23 KE, Shqipëri, Raporti i Progresit 2013, fq.30.

24 Benet Koleka, “Shqipëria prezanton në ankand 13 blloqe për eksplorimin e naftës,” Reuters, 6 maj 2014.

25 Nicholas Watson, “Shqipëria anulon shitjen e vrazhdë të Albpetrolit,” Financial Times Beyondbrics blog, 13 shkurt 2013; KE, Shqipëri, Raporti i Progresit 2013.

26 KE, Shqipëri, Raporti i Progresit 2013, fq.15. Thuhet se Republika Çeke konsideronte bllokimin e kërkesës së Shqipërisë për statusin e kandidatit; “Praga e gatshme të bllokoj radhitjen e Shqipërisë në BE lidhur me mosmarrëveshjen e ÇEZ,” Prague Post, 9 qershor 2014.



të ofroj nivelin e kërkuar të fleksibilitetit për të lejuar hyrjen e akterëve të ri në treg.²⁷

Sektori i energjisë në Bosnje-Hercegovinë e ka situatën e njëjte si atë politike me fragmentim dhe kompleksitet, me tri korniza rregullative, tre (të ndryshme) prodhues kryesorë, katër furnizues dhe një kompani të vetme, mezi funksionale të transmetimit.²⁸ Megjithatë, problemi i saj kryesor është transmetimi. Kompania shtetërore e transmetimit është kronike "kryesisht e paaftë për kryerjen e detyrimeve të saj ligjore për mirëmbajtje, zhvillim, planifikim dhe investime në infrastrukturën e transmisionit".²⁹ Furnizimi me gaz është ndarë politikisht, ku Federata e BH-së merr pjesë në projektin e planifikuar të Tubacionit Jon Adriatik (IAP), ndërsa RS kërkon të bashkohet me linjën e planifikuar të Rrjedhës së Jugut në Serbi, e cila mund të shkel normat e KE-së. Sektori i gazit në Bosnjë mbetet "pas të gjitha të tjerave [palët e Komunitetit të Energjisë] duke përfshirë edhe të porsaardhurit" mbi pajtueshmërinë.³⁰ Bosnja dhe Hercegovina është gjithashtu e varur, ndoshta e mbi-varur, në hidroelektrana.

Kroacia është shteti i vetëm në rajon që gjeneron energjinë bërthamore nëpërmjet pronësisë së saj të përbashkët të centralit Krsko në Slloveninë fqinje. Ajo ka një treg të arsyeshëm konkurrues dhe një përzjerje relativisht të ndryshme të burimeve duke përfshirë një sektor të energjisë me erë, të vogël por në rritje.³¹ Ashtu si Shqipëria, edhe Kroacia kohëve të fundit filloi një tender për eksplorimin e gazit dhe të naftës.³²

Kosova ka qymyr-linjit të bollshëm, vlerësohen të jenë rreth 10.9 miliard ton linjit ekonomikisht të shfrytëzueshme, por qymyri është i cilësisë relativisht të dobët dhe shumë ndotës.³³ Linjiti përbën pothuajse gjithë prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes në Kosovë; nuk ka impiante të

gazit apo naftës dhe ka burime minimale të ripërtërishme.³⁴ Më shumë se një e treta e energjisë elektrike humbet.³⁵

Strategjia e qeverisë për energji është e bazuar shumë në zëvendësimin e centralit të amortizuar dhe shumë ndotës Kosova A me një central të ri me djegie të linjtit, me pak përpjekje serioze të vënë në efikasitet burime të rinovueshme të energjisë. Rreth 835 njerëz në Kosovë vdesin çdo vit për shkak të ndotjes urbane të ajrit, ndërsa shumë të tjerë sëmuren nga kjo.³⁶

Maqedonia mbështetet në centrale hidroelektrike, me qymyr, gaz dhe me djegie të naftës për energjinë e saj dhe ka një treg pjesërisht të liberalizuar me një furnizues austriak, EVN Makedonija. Megjithatë, rregulla të rëndësishme të tregut mbesin të pazbatuara dhe rregullator i saj është i dobët.³⁷

Mali i Zi varet shumë nga linjiti dhe hidrocentralet dhe ka pësuar një humbje të madhe financiare kur gjiganti Podgorica Aluminium Plant (KAP) ka bërë tërheqjen "e paautorizuar dhe të papaguar" nga rrjeti i energjisë, duke shkaktuar që sistemin shtetëror të bazohet në ofruesit e tjera evropian me kosto të lartë; barra e përgjithshme tek shteti arrin 3% të BPV-së.³⁸

Serbia varet shumë nga linjiti dhe hidroelektranat, me një gamë prej centraleve elektrike të amortizuara. Sa i përket gazit ajo vazhdon të mbështetet në projektin e Rrjedhës së Jugut që Komuniteti i Energjisë dhe KE-ja e kanë identifikuar në mënyrë të përsëritur në kundërshtim me normat e BE-së.³⁹

Biznesi në këtë shkallë ofron tundime që edhe korporatat kryesore me bazë në BE janë të papërmbytshme. Në dhjetor të vitit 2011, Deutsche Telekom dhe dega e saj në Hungari Magyar Telekom kanë paguar 95.2 milionë

27 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Raporti Vjetor i Zbatimit 2013 f.28.

28 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Raporti Vjetor i Zbatimit 2013 f.29.

29 KE, Bosnje, Raporti i Progresit 2013, fq.45.

30 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Raporti Vjetor i Zbatimit 2013, fq.98-101

31 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Raporti Vjetor i Zbatimit 2013, fq.37ff.

32 Andrew MacDowall, "Nafta dhe gazi i Kroacisë: një ndryshues Adriatik i lojës?" Financial Times Beyondbrics blog, 5 Maj 2014.

33 Daniel M. Kammen et al., "Një analizë e disponueshmërisë së burimeve dhe koston, "Universiteti i Kalifornisë në dokumentin punues Berkeley, 20 maj 2012, fq.19.

34 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Raporti Vjetor i Zbatimit 2013, fq.43.

35 Humbjet teknike dhe jo-teknike të kombinuara. KE, Kosovë* Raporti i Progresit 2013, fq.41.

36 Banka Botërore, Analizat për mjedisin e vendit, Kosovë, 2010, Tabela 2.5. Një shpërthim në Kosova A vrau katër punëtorë dhe plagosi shumë të tjerë më 6 qershor 2014.

37 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Raporti Vjetor i Zbatimit 2013, pp.49-53.

38 Kjo paraqet shumë e borxhit të supozuar nga shteti pas falimentimit të centralit energjetik; KE, Mali i Zi, Raporti i Progresit 2013.

39 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Raporti Vjetor i Zbatimit 2013, fq.119; KE, Serbi, Raporti i Progresit 2013, fq.31.

Polančec, i cili zbuloi detajet e përfshirjes së Sanaderit në rast, ndërsa ai ishte në gjykim për një tjetër rast korrupsioni. Polančec deklaroi se Sanader e detyroi atë, ish-kreun e HEP Ivan Mravak, dhe Ivan Koštan, ish-kreun e kompanisë Kroate të Aluminij TLM, për të nënshkruar një sërë kontratash.

Sipas aktakuzës së lëshuar nga Zyra Kroate e Prokurorit të Shtetit (DORH), miratimi i kontratave nga Mravak nuk është në përputhje me ligjin kroat të tregtisë e as me rregulloret e HEP. Më 12 prill 2007, Mravak udhëhoqi Këshillin mbikëqyrës të HEP-së dhe Bordin e Drejtorëve për të besuar

se kontratat në mes të HEP dhe TLM si dhe Aluminij Mostar do të ishin të dobishme për kompaninë. Ai është akuzuar për abuzim të detyrës me urdhër të ish-kryeministrit Sanader. Si pasojë, HEP ka humbur rreth 85 milionë euro në një marrëveshje që u jepte Aluminijit Mostar energji elektrike nën çmimin e tregut dhe i garantonte një furnizim të cilësisë së lartë të aluminit për TLM nga Mostar. Mravak ka pranuar fajin dhe do të jetë dëshmitar kyç për akuzën.

Gjithashtu, janë ngritur padi kundër ish-këshilltarit Mravak, gjeneralit në pension Ivan Kapular, dhe ish-anëtarit të Bordit Mbikëqyrës të HEP-së Zdenko Juricic. Edhe pse Polančec dhe Koštan u paditën fillimisht, Zyra e prokurorit të shtetit në fund vendosi të heq akuzat e tyre.

**RASTI I PAPËRFUNDUAR
(NË PROCEDURË)**

Në shtator të vitit 2013, Sanader u akuzua për padinë se gjatë kohës sa ai ishte kryeministër, detyroi Mravak për të shitur energji elektrike për të dy firmat e prodhimit të aluminit, TLM në Sibenik, Kroaci dhe Aluminij në Mostar, Bosnje, me një çmim më të lirë se ai i tregut.

Sipas DORH, Sanader ka pranuar rreth 1,5 milion euro deri 2.2 milionë euro nga Debis, një ish-degë e kompanisë gjermane Daimler, e cila kishte lidhje biznesi me Aluminij Mostar, për të lehtësuar kontratat e Aluminij Mostarit dhe TLM me HEP-në. Sanader mohoi akuzat, duke pretenduar se vendimi për të shitur energji elektrike më të lirë ka qenë një vendim unanimitet që ai udhëhoqi. Ndërkohë, prokuroria ka tërhequr aktakuzën për ndryshime dhe duhet që deri në shtator të këtij viti të ri-lëshoj atë.

BURIMET

<http://www.anticorruption-croatia.org/home/news-from-croatia/131-new-corruption-charges-against-former-croatian-prime-minister>

<http://www.anticorruption-croatia.org/home/news-from-croatia/192-sixth-indictment-issued-against-former-prime-minister-ivo-sanader>

<http://www.balkaninsight.com/en/article/sixth-corruption-charge-hits-croatian-ex-pm-sanader>

<http://www.balkaneu.com/indictment-issued-croatian-power-company-hep-ceo/>

<https://reportingproject.net/occrp/index.php/ccwatch/cc-watch-briefs/1309-new-corruption-charges-against-former-croatian-pm>

<http://www.novolist.hr/Vijesti/Crna-kronika/Mravka-teret-e-za-prodaju-jeftine-struje-TLM-u-i-mostarskom-Aluminiju>

<http://www.nacional.hr/clanak/123455/pet-daimlerovih-afere>

<http://www.novolist.hr/Vijesti/Crna-kronika/Mravak-ce-na-optuzenicku-klupu-zbog-jos-650-milijuna-kuna-stete-HEP-u?articlesrclink=related>



Kroacia: Afera INA - MOL

DATA E INCIDENTIT: Një aktakuzë kundër ish-kryeministrit Sanader u lëshua në nëntor të vitit 2011 dhe gjykimi përfundoi në nëntor të vitit 2012. Zsolt Hernádi u akuzua në mars të vitit 2014 dhe është në pritje të gjykit.

PERSONAT E PËRFSHIRË:

- Ivo Sanader, ish-Kryeministër i Kroacisë,
- Zsolt Hernádi, Kryeshf Ekzekutiv i Kompanisë publike hungareze (MOL).

PËRMBLEDHJE: Ish kryeministri Ivo Sanader u akuzua për marrjen e 10 milionë euro në ryshfet nga kompania hungareze e naftës MOL, për t'i dhënë MOL-it një vend dominues në kompaninë kroate të naftës INA. Sanader u gjykua dhe u dënua prej 7 vite burg për aferën INA - MOL. Përveç kësaj, gjykata urdhëroi atë të paguajë një gjobë prej 5 milionë euro. Në tetor të vitit 2013, policia kroate lëshoi një urdhër-arrest ndërkombëtar për Zsolt Hernádi me akuzat për dhënie të ryshfetit tek Sanader.

STATUSI AKTUAL: Ivo Sanader u dënua me tre vjet e gjysmë burg në një rast të veçantë lidhur me Hypo Alpe Adria Bank dhe për shtatë vjet në rastin MOL -INA. Ai u urdhërua gjithashtu të paguajë një gjobë prej 5 milionë euro në nëntor të vitit 2012. Në mars të vitit 2014 Zsolt Hernádi u akuzua me paditë se ai i bëri shantazh Ivo Sanaderit për t'i dhënë të drejta të menaxhimit të INA kompanisë MOL. Hernádi mohon çdo keq-bërje..

Në vitin 2002 u miratua Ligji për privatizimin e INA-s, duke i lejuar kompanisë hungareze MOL që të blejë plus 25% të aksioneve në nëntor të vitit 2003 për 505 milionë USD (516 milionë euro) pas fitimit të një procesi të gjatë të ankandit.

Në vitin 2008, MOL bleu një shtesë prej 22.15 për qind të aksioneve të INA-s, duke rritur kështu pronësinë e saj në 47.16 për qind dhe duke ulur pjesën e qeverisë në 44.84 për qind. MOL ka fituar kontrollin operacional mbi INA-n.

Pas këtyre ngjarjeve, Parlamenti kroat ka formuar një komision të posaçëm parlamentar për të hetuar privatizimin, duke pretenduar se ka pasur mungesë të transparencës në këtë proces. Në dhjetor 2010, MOL ka rritur pjesën (aksionet) e saj të përgjithshme në 47,26 për qind. Më 15 mars 2011, Agjencia Kroate për Mbikëqyrjen e Shërbimeve Financiare (HANFA) ka pezulluar tregtinë në aksionet e INA-s dhe paraqiti një raport për zyrën e prokurorit të shtetit, duke pretenduar se ka pasur parregullsi në këmbim.

Një muaj më pas, USKOK (Byroja për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar) ka akuzuar ish kryeministrin kroat Ivo Sanader për marrjen e 10 milionë euro në ryshfet nga Kryesuesi i kompanisë hungareze të naftës MOL, Zsolt

Hernádi, për t'i dhënë MOL-it një vend dominues në kompaninë kroate të naftës INA. Gjykata e Qarkut të Zagrebit dënoi Ivo Sanader me tre vjet e gjysmë burg në një rast të veçantë lidhur me Hypo Alpe Adria Bank dhe për shtatë vjet në rastin MOL-INA. Ai u urdhërua gjithashtu të paguajë një gjobë prej 5 milionë euro. Sanader hodhi poshtë të gjitha akuzat për këtë rast, kur është marrë në pyetje nga USKOK. Ekipi i tij mbrojtës pohoi se rasti u nis në bazë të një depozitimi nga pronari i kompanisë petrokimike Dioki, Robert Jezić, i cili duke fajësuar Sanader u përpoq të sigurojë një pozitë më të mirë për veten e tij në gjykimin kundër tij. Gjysma e 10 milionë eurove dyshohet se janë paguar përmes kompanive të Jezićs në Zvicër.

Ish-zëvendës kryeministri Damir Polančec kishte qenë gjithashtu një i dyshuar për rastin, por USKOK hoqi dorë nga paditë për shkak se nuk kishte gjetur ndonjë dëshmi për Polančec që ndihmonte Sanader në shpërdorim të detyrës.

Në tetor të vitit 2013, policia kroate lëshoi një urdhër arresti për Hernádin dhe më 31 mars 2014, USKOK paditi atë me akuzat se ai ka shantazhuar ish-kryeministrin Ivo

SANADERI FAJTOR

Sanader për t'i dhënë të drejtat e menaxhimit të INA-s kompanisë MOL. Nëse Gjykata e Qarkut të Zagrebit mban padinë e USKOK, do ta gjykoj Hernádin në mungesë. Ndërkohë, MOL-i ka bërë të ditur mundësinë e shitjes së 49.1 për qind të aksioneve të saj në INA.

RASTI HERNADI NË PROCEDURË E SIPËR

SOURCES

<http://www.index.hr/vijesti/clanak/slucaj-inamol-10-godina-od-strateskog-partnerstva-do-medjunarodnog-spora/704076.aspx>

<http://www.anticorruption-croatia.org/home/news-from-croatia/116-second-indictment-issued-against-croatian-former-prime-minister-ivo-sanader-over-ina-mol-scandal>

<http://www.balkaninsight.com/en/article/sentence-to-sanader-on-20th-november>

<http://www.balkaninsight.com/en/article/croatia-jails-sanader-for-10-years-over-graft>

<http://www.balkaninsight.com/en/article/croatia-to-file-arrest-warrant-for-hungarian-oil-chief>

<http://www.politics.hu/20140402/croatian-anti-corruption-office-indicts-mol-chairman/>

<http://budapestbeacon.com/economics/mol-sell-49-1-interest-ina/>

[http://www.bbj.hu/business/mol-ceo-zsolt-Hernádi-indicted-in-croatia-\[updated\]_77848](http://www.bbj.hu/business/mol-ceo-zsolt-Hernádi-indicted-in-croatia-[updated]_77848)





KOSOVE: Rasti i Shpifjeve per kontraten e KEK-ut

DATA E INCIDENTIT: 2012

PERSONAT E PËRFSHIRË:

- Arbana Xharra, gazetare në gazetën Zëri
- Bejtush, Mehdi and Ilmi Zhugolli, biznesmenë
- Selvije Bajrami, gazetare në Zëri
- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

PËRMBLEDHJE: Në prill të vitit 2012, Arbana Xharra nga gazeta e pavarur ditore Zëri shkroi një artikull ku komentohet se biznesmenët vëllezërit Zhugolli mbështetën financiarisht fushatën zgjedhore të Kryeministrit Thaçi dhe se në këmbim ata fituan kontrata të majme në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK). Menjëherë pas publikimit të artikullit, Bejtush Zhugolli ka paditur Xharrën dhe Zërin. Sidoqoftë Xharra u shpall e pafajshme. Kur Selvije Bajrami, një tjetër gazetare në Zëri, publikoi një raport për seancën e parë gjyqësore, Zhugolli gjithashtu ka paditur atë, megjithatë ajo u konstatua e pafajshme..

STATUSI AKTUAL: Rastet gjyqësore janë përfunduar në favor të gazetarëve të Zërit.

Më 2 prill 2012 Arbana Xharra e gazetës së përditshme të pavarur Zëri shkroi artikullin ku komentohet një marrëveshje në mes të tre vëllezërve të quajtur Zhugolli dhe kryeministrit Hashim Thaçi. Duke përmendur mbikëqyrësit kundër korrupsionit dhe raportet e prokurimit publik ajo thotë se Ilmi, Bejtush dhe Mehdi Zhugolli, të cilët zotërojnë kompanitë e tyre private, kanë mbështetur financiarisht fushatën zgjedhore të Kryeministrit. Në këmbim, Thaçi është thënë se u ka miratuar biznesmenëve kontrata shumë fitimprurëse në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) dhe Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike KOSTT me vlerë rreth 70 milionë euro ndërmjet viteve 2008 dhe 2010.

Kompanitë Eko Trade, në pronësi të Mehdi Zhugollit dhe ACDC-KOS në pronësi të Ilmi Zhugollit kanë fituar rreth dhjetë kontrata nga KEK-u dhe KOSTT-i në lidhje me ndërrimin e instalimeve, furnizimin e pajisjeve, dhe riparimin e linjave të transmisionit. Shumica e kontratave janë dhënë direkt, d.m.th. pa tender konkurrues.

Menjëherë pas publikimit të artikullit të Xharrës, Bejtush Zhugolli ka paditur atë dhe Zërin për dëmtim të imazhit të biznesit të tij dhe ka kërkuar për dëme prej 700.000 euro. Rasti është pranuar dhe përpunuar shumë shpejt me standarde lokale: Seanca e parë gjyqësore u mbajt më 25 prill 2012.

Kur Selvije Bajrami, gjithashtu një gazetare në Zëri, publikoi një raport për seancën e parë gjyqësore Zhugolli gjithashtu e paditi atë, duke kërkuar kompensim prej 300,000 euro. Një shumë që u zvogëlua më pas në vetëm nën 34 000 euro.

Pas tri seancave gjyqësore, gjykatësja në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë Fetije Sadiku hodhi poshtë padinë kundër Xharrës në janar të vitit 2013, duke argumentuar se artikulli që ajo ka shkruar u bazua në dokumentet zyrtare dhe se ajo citoi vetëm burimet e saj por nuk ka dhënë mendimin e saj. Në prill të vitit 2014, rasti kundër Bajramit u hodh poshtë gjithashtu për arsye të ngjashme.

BURIMET

<http://en.rs.org/kosovo-returning-to-the-lawsuit-against-11-10-2012,43528.html>

<http://preportr.com/en-us/Money-and-Politics/100-million-92>

<http://birn.eu.com/en/news-and-events/the-elections-in-kosovo-judicial-council-kjc>

[http://www.Zëri.info/artikulli/32507/zhugolli-humb-prape-ndaj-gazetes-Zëri-\(in-Albanian\)](http://www.Zëri.info/artikulli/32507/zhugolli-humb-prape-ndaj-gazetes-Zëri-(in-Albanian))

**NUK KA
HETIME**

FAJTOR

RAST I
MBYLLUR

KOSOVE: Afera UNMIK – KEK

DATA E INCIDENTIT: Hetimi filloi në vitin 2001 dhe përfundoi në vitin 2003.

PERSONAT E PËRFSHIRË:

- ish-menaxheri ekzekutiv i KEK-ut, Jo Trutschler

PËRMBLEDHJE: Pas vitit 1999, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) është menaxhuar nga menaxhmenti ndërkombëtar i emëruar nga UNMIK-u. Nga vitet 2000-2002, Jo Trutschler ishte menaxher udhëheqës i KEK-ut. Gjatë mandatit të tij u zbulua se ai kishte fituar rreth 4.3 milionë dollarë (atëherë rreth 3.7 milion euro) dhe ka transferuar shumën tek kompanitë fiktive në Gjibraltar. Hetuesit e OKB-së zbuluan se përveç kësaj, Trutschler kishte falsifikuar diplomën e tij me ç'rast pretendonte përvojë më të madhe në menaxhim. Si rezultat i këtij mashtrimi, një gjykatë gjermane dënoi atë me tre vjet burg për shkelje të besimit dhe të keqpërdorimit të titullit akademik. Shumica e parave u rimëkëmbën.

STATUSI AKTUAL I RASTIT: Jo Trutschler u shpall fajtor dhe ka vuajtur dënimin prej tre vjet e gjysmë. Shumica e fondeve u gjetën dhe u kthyen në Korporatën Energjetike të Kosovës.

Pas vitit 1999, Korporata Energjetike e Kosovës është menaxhuar nga menaxhmenti ndërkombëtar në emër të UNMIK-ut, Jo Trutschler u emërua menaxher ndërkombëtar i KEK-ut, në vitin 2000.

Gjatë kohës që ai menaxhonte kompaninë u zbulua se paratë ishin zhdukur dhe u njoftuan Zyra e OKB-së e Hetimeve të Mbikëqyrjes së Brendshme dhe Zyra Evropiane kundër-mashtrimit. U zbulua se ai kishte fituar rreth 4.3 milionë dollarë dhe ka transferuar shumën tek kompani fiktive në Gjibraltar. Ai pastaj u përpoq të transferonte këto para në Belize në prill të vitit 2002, por ky transaksion ishte bllokuar. Në fillim të majit 2002, llogaritë në Gjibraltar u bllokuan për shkak të veprimt të gjykatës nga OLAF.

Hetimi gjithashtu konfirmoi se Trutschler kishte marrë në mënyrë të paligjshme edhe 220,000 euro tjera të fondeve të KEK-ut përmes dorëzimit të dy faturave të rrejshme, gjoja nga dy kompani të huaja që kanë të bëjnë me energji, por me pagesat që në të vërtetë shkonin në llogaritë e tij në Gjibraltar.

Hetuesit e OKB-së gjithashtu zbuluan se Trutschler kishte një diplomë të rreme dhe rezymeja e tij ishte e rreme. Ai nuk kishte studiuar në Boston dhe Florida, e as që ka një PhD në Aachen. Dhe kompania që ai pretendonte se kishte drejtuar me 160 të punësuar kishte falimentuar.

Më 26 dhjetor 2003, sekretari i përgjithshëm i OKB-së Kofi Annan njoftoi në Asambleenë e Përgjithshme të OKB-së se hetimet kanë konfirmuar se ish-zyrtari i lartë i UNMIK-ut Jo Trutschler kishte kryer një vepër penale dhe kishte dëmtuar Kompaninë Energjetike të Kosovës (KEK) në vlerë prej 4.3 milionë dollarë. Në korrik të vitit 2002, rasti iu referua autoriteteve në vendlindjen e Trutschler në Gjermani. Ai është gjykuar dhe dënuar për shkelje të besimit dhe përdorim të rremë të një titulli akademik dhe u dënua me burgim tre vjet e gjashtë muaj. Shumica e parave u gjetën dhe u kthyen në llogarinë e KEK-ut.

BURIMET

Raporti i OKB-së për rastin: <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N03/612/42/PDF/N0361242.pdf?OpenElement>

Kosovo 2.0: <http://www.kosovotwopointzero.com/en/article/91/a-dangerous-game-investments-in-the-energy-sector-in-kosovo>

Gazeta e përditshme suedeze Dagens Nyheter

: <http://www.dn.se/kultur-noje/kulturdebatt/part-2-the-un-state-and-the-seven-robbers/>

Instituti i raportimit të Luftës dhe Pages: <http://iwpr.net/report-news/kosovo-arrest-follows-electricity-funds-probe>

Deklaratë për shtyp nga OLAF: http://ec.europa.eu/anti_fraud/media-corner/press-releases/press-releases/2003/20030617_01_en.htm



MAQEDONIA: Karteli i tregtimit të energjise elektrike dhe rastet e evazionit fiskal

DATA E INCIDENTIT: Ankandi i energjisë elektrike në fjalë u zhvillua në janar 2012

PERSONAT E PËRFSHIRË:

- Komisioni i Konkurrencës i Maqedonisë
- GEN – I, Rudnap Group, ESPADA dhe EFT

PËRMBLEDHJE: Në vitin 2012, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës i Maqedonisë ngriti padi për kundërvajtje kundër katër firmave të tregtimit të energjisë elektrike me dyshimin se ata kishin krijuar një kartel në mënyrë që të mund të diktonin çmimin e importit të energjisë elektrike përmes ofertave të tyre në një tender në janar 2012. Më vonë gjatë këtij viti, zyra doganore gjithashtu akuzoi tre kompani të tregtimit të energjisë elektrike, si detyra doganore shtesë, duke theksuar se ata kishin përdorur metoda të ndryshme për të shmangur pagesën e këtyre tarifave.

STATUSI AKTUAL I RASTIT: Prej lajmit fillestar rreth rastit të pretenduar të kartelit nuk ka pasur asnjë lajm të transmetuar publikisht nëse rastet kanë përfunduar; nëse ka pasur ndonjë gjobë për kompanitë të cilat janë akuzuar për shkeljen e ligjit, e as nëse ata kanë parashtruar ankesa. Megjithatë, me anë të kërkesës së Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës për të komentuar rreth çështjes, një zëdhënës konfirmoi se ata kanë ngritur akuzat për kundërvajtje kundër kompanive që supozohet se kanë krijuar kartelin dhe se ky proces është ende në vazhdim. Në rastin e evazionit tatimor nuk është e qartë nëse kompanitë kanë paguar ose jo dhe nëse janë ndërmarrë veprime të mëtejshme.

Në dhjetor 2011 dhe janar 2012 janë shpallur tenderët për importimin e energjisë elektrike për të mbuluar mungesat për shkak të rritjes së konsumit (temperaturat shumë të ulëta të kombinuara me përdorim të lartë të energjisë elektrike për ngrohje). Në fund të janarit 2012, qeveria ka udhëzuar ELEM-in, gjeneratorin shtetëror të energjisë elektrike, që të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e tenderit për shqyrtim në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës.


Në 27 mars 2012, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ngriti padi për kundërvajtje kundër katër firmave të tregtimit të energjisë elektrike me dyshimin se ata e thyen ligjin duke bashkëpunuar për ofertat e tyre në tenderin për prokurimin e energjisë elektrike të lansuar nga ELEM-i në janar 2012.

Komisioni konsideroi se ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se katër kompanitë - GEN - I, Grupi Rudnap, Espada dhe EFT – kanë krijuar një organizatë kartel në mënyrë që

ata të mund të diktojnë çmimin e importeve të energjisë elektrike dhe të kenë një avantazh ndaj firmave të tjera ofertuese në këtë tender.

Kompanitë e akuzuara i kanë mohuar të gjitha akuzat, duke deklaruar se konkurrenca në tregun e energjisë elektrike është e shëndoshë.

Është interesante fakti se Cedomir Kraljevski u shkarkua si kryetar i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës në prill 2012, një muaj pas nxjerrjes në dritë të këtyre rasteve, pavarësisht se ai mbeti anëtar i Komisionit. Nuk ka asnjë lajm pse u zëvendësua kryetari, pavarësisht se qeveria ka zëvendësuar zyrtarë të shumtë në atë kohë gjatë një riorganizimi të quajtur Vala e Re, i cili u realizua në 22 institucione dhe agjenci, por nuk e përfshiu zëvendësimin e ndonjë prej Ministrave.





Akuzat e aktivitetit të kartelit nuk duket se kanë dëmtuar pozitën e atyre që u pretenduan nga media për përfshirje: Në të vërtetë, Kocho Angjushev, themeluesi i njëres prej kompanive, EFT, u largua nga kompania në shkurt 2013, një vit pas ngritjes së akuzave dhe u zgjodh kryetar i Shoqatës së Energjisë të Maqedonisë (MEA) në Dhomën e Tregtisë.

Disa muaj pasi media raportoi rastin e aktiviteteve të dyshuara të kartelit, në nëntor 2012 Zyra Doganore e Maqedonisë njoftoi se gjeti parregullsi gjatë inspektimeve rutinë, gjatë krahasimit të sasisë së energjisë elektrike në vend, të cilat kalojnë kontrollet doganore me të dhëna për sasi të importit, eksportit dhe energjisë elektrike të cilat kalojnë sistemin e transmisionit për periudhën 2010-2012. Zyra

Doganore gjeti parregullsi të mëdha në të tri kompanitë tregtare të energjisë elektrike, pas së cilës u aprovuan vendimet për pagesë shtesë të detyrimeve doganore për rreth 113 milion denarë (1.8 milion euro).

Në rastin e parë, një kompani nga Shkupi ka shmangur detyrimet doganore që arrijnë në rreth 79.400.000 denarë (1,3 milion euro). Gjatë vitit 2011 dhe 2012 kompania ka dorëzuar një total prej 154.790 MWh energji elektrike, por një sasi e energjisë së importuar ishte hequr në mënyrë të paligjshme nga mbikëqyrja doganore pa paguar taksën doganore e cila kapte shumën në 71.6 milion denarë (1.16 milion euro). Gjithashtu, Zyra Doganore zbuloi shtojcat e Marrëveshjes së Përgjithshme për shitjen e energjisë elektrike, ku kostoja për njësi e MWh energji elektrike e cila ishte blerë dukshëm me çmim më të lartë në krahasim me çmimin për njësi të cilin e kishte deklaruar, dhe në këtë mënyrë kompania shmangu pagesën të taksave doganore edhe për 7.800.000 denarë (0.12 milionë euro).

Në rastin e dytë, një kompani nga Shkupi ka shmangur pagesën e detyrimeve doganore prej rreth 30 milionë denarë (0.5 milion euro) dhe Zyra e doganës ka miratuar dy vendime për pagesën plotësuese të borxhit doganor. Në rastin e tretë, Zyra i ka ngarkuar me tarifatat doganore shtesë prej 3.5 milion denarë (0.06 milionë euro) për energji

elektrike e cila është caktuar për një kompani, por aktualisht ajo u ri-shit pa paguar taksat e duhura.

Në deklaratën zyrtare nuk u identifikuan kompanitë që kishin shmangur taksat. Megjithatë, revista javore 'Faktor' raportoi se jo-zyrtarisht kishte mësuar nga 'burime të qeverisë' se kompanitë ishin Rudnap dhe Gen- I. Nuk ka informacion në dispozicion të publikut se nëse kompanitë kanë paguar atë çka detyrohen apo nëse janë zhvilluar ndjekjet penale.

BURIMET

http://www.karanovic-nikolic.com/wp-content/uploads/2012/11/karanovic-nikolic-focus_on_competition_2012-book-WEB.pdf

<http://www.mkd.mk/22152/crna-hronika/uvozni-struja-sud-karteli;>

<http://bukvar.mk/news/utvrden-monopol-pri-uvaz-na-struja?newsid=OvIm;>

<http://www.kumanovonews.com/vesti/kraljevski-smenet-od-antimonopolska-uprava>

<http://www.dnevnik.mk/?ItemID=2D3DDB3AA2D27D4190E621C798F627F7>

<http://faktor.mk/archives/8399>

<http://grid.mk/read/news/102081911/1110346/krivichni-prijavi-za-nelegalen-uvaz-na-struja> <http://grid.mk/read/news/102081911/1107851/uvezuvale-struja-ne-plakjale-carina> <http://www.utrinski.mk/?ItemID=475EF7362BBF64FB8CD75FDD7D5A08C> http://www.kapital.mk/mk/makedonija/92941/kocho_angjushev_nov_pretseda-tel_na_makedonskata_energetska_zaednica.aspx

<http://customs.gov.mk/ShowNews.aspx?ItemID=2544&mid=1099&tabId=1&tabindex=0>



Mali i Zi: Afera e vjedhjes së energjisë elektrike në KAP



Data e incidentit: Shkurt-Maj 2013

Personat e përfshirë: Ministri i Ekonomisë - Vladimir Kavarić

Kryetari i CGES (Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike të Malit të Zi) Bordi i Drejtorëve - Dragan Laketić

Përmbledhje: Në fillim të vitit 2013, qeveria Malazeze lejoi vjedhjen e energjisë elektrike nga Sistemi Ndërlidhës i Energjisë Evropiane për fabrikën e aluminit të Podgoricës (KAP), pasi kompania e energjisë elektrike Elektroprivreda Crne Gore (EPCG) ndaloi furnizimin me energji elektrike për kompaninë. Kjo u bë publike vetëm disa muaj më pas, kur përfaqësuesit e Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energjinë Elektrike (ENTSO-E) e paralajmëruan Malin e Zi për të ndaluar praktika të tilla dhe urdhëruan kthimin e energjisë elektrike të vjedhur ose i gjithë vendi do të mund të përjashtohet nga rrjeti Evropian. Qeveria e Malit të Zi ra dakord për ta bërë këtë, mirëpo çmimi i energjisë elektrike të vjedhur u mbulua nga buxheti i shtetit dhe fitimet e CGES-it. Në fund të fundit, publiku është ai që do të paguaj çmimin e energjisë së vjedhur pasi që ndërkohë KAP-i kishte falimentuar.

Statusi aktual i rastit: Prokurorët shtetëror janë ende duke hetuar këtë rast, por deri më tani askush nuk është akuzuar. Buxheti i shtetit parashikon se vjedhja e energjisë është paguar nga CGES-i dhe është miratuar në Parlamentin e Malit të Zi dhe është në fuqi.

Pas privatizimit të kompanisë shtetërore të energjisë elektrike të Malit të Zi, EPCG dhe shitjes së rreth 44 për qind të aksioneve tek kompania energjetike Italiane A2A, EPCG me zor ka përballuar presionin nga pronarët e saj të ri për të shkurtuar subvencionet për KAP-in (fabrikën e aluminit të Podgoricës), konsumuesin më të madh në vend dhe për

të ndaluar tolerimin e faturave të papaguara të energjisë elektrike të KAP-it. Në një moment këto fatura kanë qenë në vlerë mbi 50 milionë euro pa asnjë plan të qartë për pagimin e këtij borxhi.

Së fundi, në shkurt 2013, EPCG-ja ka ndalur furnizimin e KAP-it. Arsyeja zyrtare ishte se KAP-i nuk kishte nënshkruar një kontratë të re me EPCG-n për furnizim me energji elektrike.

Për qeverinë, mbyllja e KAP-it ishte një problem i dukshëm, pasi që do të shkaktonte shpenzime të mëdha shtesë. CGES-i, kompania e transmisionit e Malit të Zi dhe hallka kryesore për shpërndarjen e energjisë elektrike për konsumatorët e mëdhenj, filloi të marr energji elektrike nga rrjeti Evropian i energjisë elektrike pa leje, në mënyrë për të mbajtur KAP-in në funksion dhe këtë e bëri prej muajit mars deri në maj 2013. Kjo u mbajt sekret për qytetarët malazez, deri atëherë kur përfaqësuesit e Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energjinë Elektrike (ENTSO-E) publikisht e paralajmëruan Malin e Zi për të ndaluar marrjen e energjisë elektrike në mënyrë të paligjshme nga sistemi Evropian në fund të majit 2013 dhe e kërcënuan atë me përjashtim nga rrjeti Evropian.

Në të njëjtin muaj, për herë të parë, media lokale raportoi se KAP-i ishte duke vjedhur energji elektrike nga rrjeti Evropian dhe se ENTSO-E e ka kërcënuar Malin e Zi me përjashtim.



Megjithatë, ishte MANS-i i cili i pari zbuloi në korrik 2013 se energjia elektrike në fakt ishte vjedhur nga CGES-i, me dijeninë e plotë të qeverisë së Malit të Zi, si dhe Agjencisë së Rregullatorit të Energjisë të Malit të Zi. MANS-i ka siguruar një dokument nga CGES-i në Ministrinë e Ekonomisë e cila e informon Ministrinë se CGES-i ka filluar që në mënyrë të paligjshme të marrë energji nga sistemi i ENSTO-E. Më vonë MANS-i konfirmoi se i njëjti informacion iu dërgua Zëvendës Kryeministrit dhe Kryetarit të Kuvendit Kombëtar të Malit të Zi. Asnjë prej tyre nuk bëri asgjë për të ndaluar këtë praktikë në atë kohë, e as nuk informuan publikun dhe as prokurorin shtetëror lidhur me situatën.

Pas këtij zbulimi, Zyra e Prokurorit të Shtetit nisi një hetim për këtë rast, por edhe pas një viti pune në këtë drejtim hetimet ende nuk kanë përfunduar. Drejtori Financiar i KAP-it (përfaqësues i CEAC - bashkëpronar i KAP-it) u arrestua dhe u lirua për mungesë të akuzave konkrete. Asnjë zyrtar publik malazez nuk u mbajt përgjegjës për një shkelje të qartë të ligjit dhe procedurave dhe faktin se kostoja e energjisë së vjedhur do të paguhet nga publiku malazez.

Buxheti i vitit 2014 vlerëson se shuma prej 3 milion euro për kthimin e energjisë elektrike të vjedhur te ENSTO-E do të mbulohet nga fitimet e CGES-it. Zyra e Prokurorit të Shtetit ka filluar hetimet, por deri më tani askush nuk është akuzuar për ndonjë gjë. Dokumentet e siguruar nga MANS-i tregojnë se zyrtarët e Qeverisë dhe Parlamentit ishin në dijeni të kësaj praktike të paligjshme dhe nuk bënë asgjë për të ndaluar CGES-in dhe KAP-in nga vjedhja e energjisë elektrike nga rrjeti Evropian.

Nga këto para, kanë mundur të përfitojnë qytetarët përmes përmirësimit të cilësisë së transmisionit të

energjisë në Mal të Zi. KAP-it, në bashkë pronësi me një kompani private, nuk i është bërë presion që të paguaj këtë faturë të energjisë elektrike.

Burimet

Informacioni nga Qeveria e Malit të Zi, sidomos Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia Malazeze e Rregullatorit të Energjisë në lidhje me këtë rast. Shumica e informacionit është marrë duke përdorur Aktin e Lirisë së Informacionit.

Mbulimi nga mediat

<http://balkans.aljazeera.net/vijesti/kap-na-meti-tuzilastva-i-stranij-banaka> <http://www.bankar.me/2013/06/28/istraga-o-kradi-struje-u-kap-u/>

<http://www.slobodnaevropa.org/archive/news/20130628/500/500.html?id=25030728>

<http://www2.rtcg.me/vijesti/ekonomija/17452/istraga-o-kradi-struje-u-kap-u.html>

<http://balkans.aljazeera.net/vijesti/uhapsen-finansijski-direktor-kap>

<http://www.dan.co.me/?nivo=3&rubrika=Ekonomija&clanak=421995&datum=2014-02-25&naslov=Vlada%20tri%20miliona%20daje%20za%20ukradenu%20struju>

Mbulimi nga mediat në gjuhën angleze

<http://www.reuters.com/article/2013/06/14/montenegro-kap-idUSL5N0EQ3KS20130614>

<http://www.intellinews.com/montenegro-1017/montenegro-s-cges-to-return-electricity-stolen-from-europe-delays-kap-power-cut-8075/>

Reuters: <http://206.132.6.105/article/energyOilNews/idAFL5N0EI3MZ20130606>



Bosnja dhe Hercegovina/ Mali i zi: Tregtimi i energjisë elektrike

Data e incidentit: Transaksionet kanë ndodhur në vitet 1999-2000, por hetimet kanë zgjatur deri në vitin 2008.

Personat e përfshirë: Vuk Hamović, Drejtori i atëhershëm, GML International Limited, Londër,

Elektroprivreda Crne Gore – Kompania Malazeze e energjisë elektrike

Elektroprivreda Republike Srpske – Kompania e energjisë elektrike të RS

Përmbledhje: Në vitin 1999 USAID i dha qeverisë malazeze një donacion prej 11.9 milionë dollarë (që ishin ekuivalente me 13.4 milionë euro), pjesë e të cilit ishte mbulimi i borxhit të EPCG-së për importet e energjisë elektrike nga Elektroprivreda RS nga Bosnje-Hercegovinë. Megjithatë biznesmeni serb Vuk Hamović, Drejtori i atëhershëm i GML-së me qendër në Londër, kishte blerë borxhet e EPCG-së pak para donacioneve të USAID-it, duke krijuar dyshime se paratë nga USAID po shpërndaheshin qëllimisht për GML-në. Hetimet e bëra nga Zyra e Mashtrimeve të Rënda në Mbretërinë e Bashkuar, Prokurori i BH-së dhe Inspektori i Gjeneral i USAID-it përfunduan pa ndjekje penale.

Statusi aktual i rastit: Prokurori nga Bosnia e Hercegovina suspendoi hetimet e tij në vitin 2006 dhe Zyra e Mashtrimeve të Rënda në MB suspendoi hetimet e saj në vitin 2008 për shkak të mundësisë së ulët për të siguruar një ndjekje penale. Rezultatet e hetimit të USAID-it janë të panjohura.

Në vitin 1999, kompania shtetërore e energjisë elektrike Elektroprivreda Crne Gore (EPCG) kishte borxhe të mëdha ndaj Elektroprivreda Republike Srpske (EPRS) kompani

në Bosnjë-Hercegovinë, si rezultat i importit të energjisë elektrike.

Në verën e vitit 1999, biznesmeni serb Vuk Hamović, përmes kompanisë GML me qendër në MB ku ai ishte drejtor deri në vitin 2003, kishte filluar ta blejë borxhin që EPCG i kishte borxh EPRS. Ideja e tregimit të borxhit është se një kompani e blen të drejtën për të mbledhur borxhin e një organizate. Kostoja e borxhit varet nga mundësitë për tu paguar. Në të gjitha këto transaksione, GML ka fituar të holla duke blerë borxhin me një zbritje prej 30 për qind, sipas një email në Qendrën për Gazetari Hulumtuese (CIN) nga zëdhënësi i EFT Nenad Savić. Savić tha se zbritja ishte zbatuar vetëm për firmat private ishte një çmim i drejtë për tregun dhe se EPRS ishte paguar në mënyrë të plotë dhe nuk ka pësuar humbje financiare. Në fund të fundit, kreditë e tyre ndihmuan duke siguruar likuiditet në sistem, tha ai.

Hamović, në një intervistë në vitin 2008 për televizionin e Malit të Zi, përshkroi transaksionet si një hua pa interes, në të cilën ai kishte paguar borxhet e EPCG-së për kompanitë e qymyrit që furnizonin EPRS-në. I pyetur se çfarë ishte interesi i tij në lidhje me këtë, ai e përshkroi atë si një situatë win-win (fitore) në të cilën ai fitoi një zbritje nga kompanitë duke i paguar ato menjëherë dhe në para të gatshme, të cilat i siguronin fitim më shumë se sa humbje duke i ofruar hua pa interes për EPCG-në.

Në të njëjtën kohë, USAID po ofronte ndihmë financiare për të ndihmuar Malin e Zi, duke përfshirë 11.900.000 USD (atëherë ekuivalente prej 13.4 milion euro) që ishte vendosur mënyrë për të mbuluar borxhet e EPCG-së kundrejt EPRS-së. Më 30 gusht USAID dërgoi 3.7 milion USD tek EPRS për të paguar faturat e EPCG-së. Një javë më vonë, EPCG-ja i dërgoi një letër EPRS-së duke theksuar se EPCG-ja nuk i detyrohej EPRS-së dhe duke deklaruar se paratë duhet të ridrejtoheshin për të paguar GML-në dhe

NDËRPRERJA E HETIMEVE

kreditorët e tjerë. Ky model u përsërit në vitin 1999 dhe 2000 tek GML me marrjen e borxhit para se të kryheshin pagesat nga USAID. Gjatë procesit, 4,3 milion USD iu ripaguan GML-së deri në shkurt të vitit 2000 duke përdorur fondet e USAID-it.

Afati kohor i mbulimit të borxhit të EPCG-së nga Hamović pak para se të merrte donacionet nga USAID ngriti dyshime. Hetimet u hapën nga Zyra e Mashtrimeve të Rënda (SFO), MB, Inspektori Gjeneral i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zyra e prokurorit të Gjykatës së BH-së. Sipas CIN, Jonathan Ratel prokuror ndërkombëtar për zyrën në BH lëshoi një Urdhër për kryerjen e një hetimi në vitin 2003, i cili në shënjestër kishte Hamovićin së bashku me Slobodan Mrdiç dhe Svetozar Ačimović, ish-drejtorë gjeneral të Elektroprivreda RS (EPRS) dhe Bosko Lemez, ish-ministri i Industrisë, Energjisë dhe Minierave në qeverinë e RS. Në urdhër, prokurori shkroi se kishte dëshmi që të tre zyrtarët mund të kenë kryer krime duke përfshirë abuzimin e pozitës zyrtare, nënshkrimin e kontratave dëmtuese, zbulimin e sekreteve të biznesit dhe dhënien e marrjen e ryshfetit. Hetuesit thanë se EP e Malit të Zi dhe EPRS-ja nuk kanë pasur nevojë ta shesin dhe ta tregtojnë borxhin kur paratë nga USAID-i tashmë ishin në dispozicion, bazuar në urdhëresë.

Hamović në intervistën e tij në televizionin të Malit të Zi deklaroi se donacionet e USAID-it në Mal të Zi në përgjithësi nuk kanë qenë sekrete dhe se ai kishte besim

që do t'i merrte paratë e tij nga EPCG-ja përfundimisht. Ai kishte mohuar çdo keq-bërje.

Burimet

<http://www.cin.ba/en/>

[istraga-protiv-vuka-hamovica-i-eft-ja-obustavljenja-u-bih/](#)

<http://www.cin.ba/en/>

[eft-u-fokusu-interesovanja-sad-velike-britanije-i-bih/](#)

https://reportingproject.net/powerbrokers/sub_country04.html

<http://www.cin.ba/en/gospodar-balkanske-struje/>

<http://www.cin.ba/en/>

[sfo-obustavio-istragu-protiv-hamovica/](#)

<http://www.vukhamovic.com/tvcg.html>

<http://www.cin.ba/en/>

[odgada-se-podizanje-optuznice-protiv-hamovica/](#)

<http://www.theguardian.com/uk/2008/jun/03/ukcrime.internationalcrime>

<http://www.ft.com/intl/cms/s/0/ceda076e-3108-11dd-bc93-000077b07658.html#axzz33sUPw8rr>



Serbi : Skandali në minierën e Kolubarës



Data e incidentit: 2004-2009 - çështjet dolën në media në vitin 2011

Personat e përfshirë: Mr Dragan Tomić, ish-Drejtor i minierës Kolubara,

Z. Vladan Jovičić, ish-Drejtor i minierës Kolubara,

Z. Radisav Ranković, ish-Drejtor për aktivitete komerciale,

Z. Radislav Milić, ish-Drejtor i minierave të hapura të argjilave,

Z. Vladan Radovanović, ish-drejtor teknik i minierës të hapura të argjilave, Kolubara,

Z. Milan Petrović, ish-Drejtor i fushës D të Kolubarës,

Z. Milutin Bobić, ish-Drejtor i fushës Perëndimore Tamnava,

Z. Živojin Jovanović, ish-Drejtor i fushës lindore Tamnava,

Z. Svetolik Šimić, ish-Drejtor i fushës B,

Z. Slavoljub Pavlović, ish-Drejtor i Ltd Kolubara Construction,

Z. Duško Obradović, ish-drejtor i shërbimeve të Kolubarës

Z. Radosav Savatijević, gjithashtu i njohur si Kene, ish-anëtar i bordit drejtues të kompanisë së energjisë elektrike shtetërore të Serbisë EPS - Elektroprivreda Srbije (pronar i Minierave Kolubara)

Përmbledhje: Dragan Tomić së bashku me 16 njerëz të tjerë nga kompania minerare Kolubara dhe kompanitë private të cilat bënë ri-shitjen e linjitit ose dhënien me qira të makinerisë minierë Kolubara, u arrestuan më 3 tetor 2011. Tomić nga 2004-2008 ka qenë Drejtori i Përgjithshëm i minierës së linjitit Kolubara dhe deri në gusht të vitit 2009 ishte gjithashtu Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i EPS-së. Nga viti 2008, ai ishte anëtar i Kuvendit të Kolubarës. Gjithsej 28 njerëz janë akuzuar për parregullsi

rreth marrjes së pajisjeve për minierën Kolubara, duke shkaktuar kështu dëme serioze në financat e kompanisë.

Statusi aktual i rastit: Më 31 gusht 2012 Radosav Savatijević u lirua nga paraburgimi dhe është në pritje të seancës së parë gjyqësore për rastin. Më 21 shtator 2012 Dragan Tomić dhe Vladan Jovičić, të dyshuarit kryesor u liruan pas 1 muaji në paraburgimi, pas një vendimi nga gjykata e apelit. Ata janë në pritje të seancës së parë gjyqësore për rastin.

Ndërmjet viteve 2004 dhe 2009, 12 menaxherë të nivelit të lartë të kompanisë minerare të kufizuar Kolubara së bashku me 16 pronarë të kompanive private kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare dhe kanë shkaktuar dëme në vlerë prej më shumë se 937 milion denarë (8.1 milion euro) ndaj kompanisë minerare Kolubara . Ata janë akuzuar për kryerjen me vetëdije të një numri të veprave penale.

Në rastin gjyqësor Ki.Po.46/11 ata janë akuzuar për përfitime të paligjshme nga keqpërdorimi i burimeve dhe pozitave të tyre zyrtare në kompaninë e minierave Kolubara . Ata janë akuzuar për marrjen me qira të pajisjeve mekanike në mënyrë të paligjshme nga kompanitë private dhe për udhëzimin e operatorëve të tyre për të raportuar në mënyrë të rreme orët e punës.

Më i spikaturi në mesin e pronarëve të kompanive private është z.Radosav Savatijević – Kene, i cili më parë ishte anëtar i bordit menaxhues të EPS-së.

Një aspekt tjetër shqetësues i rastit është se gjatë periudhës në fjalë Kolubara nëpërmjet EPS-së ishte përfutuese e një kredie nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e energjisë II të EPS-së, e cila krenohet



në promovimin e standardeve të qeverisjes së mirë të korporatave në vendet ku ato operojnë. Përpjekjet e përsëritura nga CEKOR për të ngritur çështjet me BERZH-in nuk e kanë parandaluar bankën nga miratimi i një kredie tjetër për minierat Kolubara në vitin 2011.

Në një rast të veçantë të njohur si Kolubara e vogël, Tomić dhe pesë të tjerë u akuzuan për mashtrim të shitjes së mbetjeve të metaleve nga kompania minerare Kolubara tek INOS Sirovine Lazarevac për rreth gjysmën e çmimit të tregut. Megjithatë, ata u shpallën të pafajshëm në këtë rast, meqë nuk mund të përcaktohej nëse ata kishin qenë në dijeni të çmimit të tregut të mbetjeve të metalit.

Burimet:

Në anglisht

http://www.b92.net/eng/insajder/index.php?yyyy=2011&mm=01&dd=31&nav_id=74497
http://www.b92.net/eng/insajder/index.php?yyyy=2011&mm=02&dd=07&nav_id=74527
http://www.b92.net/eng/news/crimes.php?yyyy=2011&mm=10&dd=04&nav_id=76691
<https://reportingproject.net/occrp/index.php/ccwatch/cc-watch-briefs/1165-serbia-17-arrested-for-alleged-embezzlement-from-coal-mine>
<https://reportingproject.net/occrp/index.php/en/ccwatch/cc-watch-briefs/1476-serbia-28-indicted-for-embezzlement>
<http://bankwatch.org/sites/default/files/EBRD-coal-corruption.pdf>
http://www.theecologist.org/News/news_round_up/2202593/ebd_eyes_wide_shut_to_coal_sector_corruption.html

Burimet e tjera:

<http://www.ustavni.sud.rs/page/predmet/sr-Latn-CS/8419/?NOLAYOUT=1>
<http://www.vesti-online.com/Vesti/Hronika/168886/Uhapseni-rukovodioci-Kolubare>

Kolubara e vogël:

<https://reportingproject.net/occrp/index.php/ccwatch/cc-watch-briefs/1572-serbia-coal-mine-corruption-trial-begins>
http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2013&mm=12&dd=03&nav_id=784792
<http://www.politika.rs/rubrike/Hronika/Bivsi-direktor-Kolubare-Dragan-Tomic-oslobodjen-optuzbi.lt.html>
<http://antikorupcija.yucom.org.rs/kolubara/>





Perkrahur nga:

